



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.51/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 30.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.51/2025 e datës 28.12.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 28.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se aktivistët e LVV-së, me datë 28.12.2025 rreth orës 12:00, kanë vërejtur se në sheshin kryesor të qytetit të Podujevës, kandidati i LDK-së, Visar Hoti ka vendosur materialin e tij propagandistik zgjedhor(kartela/flyer me fotografinë, emrin dhe identitetin e tij politik) drejtpërdrejt në strukturat metalike dhe ndriçuese të dekorimeve publike festive të Vitit të Ri. Këto përbejnë pasuri publike dhe shërbejnë për qëllim estetike dhe kulturore të përgjithshme për qytetarët. Këto dekorime janë të financuara dhe të menaxhuara nga autoritetet komunale dhe janë të destinuara për përdorim të përbashkët, pa dallim apo favorizim politik. Tutje në ankesë theksohet se ky veprim nuk është i rastësishëm, por përben shfrytëzim të vetëdijshëm të hapësirës dhe pasurisë publike për qëllim të fushatës zgjedhore, në kundërshtim me parimet e barazisë së garës dhe neutralitetit të institucioneve dhe pasurisë publike.

Tutje kanë theksuar se dekorimet e vendosura në qytetin e Podujevës, janë pasuri publike në kuptim të nenit 36 të LZP-së. Ato janë të financuara, vendosura dhe mirëmbajtura nga komuna dhe shërbejnë në funksion publik, simbolik dhe estetik. Vendosja e materialeve zgjedhore mbi këto dekorime përbën ndërhyrje direkte në pasurinë publike dhe përdorimin e saj për promovimin politik individual.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si prova fotografi në të cilat shihen njoftimet e shpërndara.

Në përgjigjen në ankesë dorëzuar me datë 25.12.2025, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës kanë theksuar se pretendimet se kandidati i LDK-së, Visar Hoti ka vendosur vizitkarta në disa hapësira që nuk dihet saktë edhe përdorimi i tyre, ngase nga foto duken thjesht disa hekura aty, teksa vendosjen mund ta kenë bërë edhe vet ankuesi e pastaj të abuzoj me të drejtën e ankesës- ku pretendojnë që të ketë ndodhur në të kaluarën. Tutje theksojnë se kjo strukturë metalike për tu konsideruar publike duhet të ishte ofruar ndonjë provë apo dëshmi pronësie nga organi kompetent komunal, por që vërtetë pretendimi është krejtësisht i pabazuar. Tutje kane theksuar se Visar Hoti nuk bart asnjë funksion publik, i njëjti punon si Analist i Larte i Kredive në NLB Bank në Prishtinë. Kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzoj ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka shpërndarë material zgjedhor/flyer drejtpërdrejt në strukturat metalike dhe ndriçuese të dekorimeve publike festive të Vitit të Ri, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se me veprimet e përshkruara në ankesë nuk është provuar shkelja e dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postëreve , ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*, pasi që në fotografitë e bashkangjitura në ankesë shihen kartela me emrin dhe numrin e tij si kandidat, ndërsa nuk dihet vendi, ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar, dhe nuk dihet se kush e ka vendosur materialin zgjedhor.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e kartelave/flyer në strukturat metalike dhe ndriçuese të dekorimeve publike festive të Vitit të Ri, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik LVV nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj vendin ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar dhe se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe sipas Rregullore NR.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave, neni 5, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3 ankesat që dorëzohen në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të

dhëna: 1.3.Vendin Kohën, datën dhe orën kur ka ndodhur shkelja, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se ku janë shpërndarë këto kartela, apo se kush i ka vendosur, në cilën orë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe nga provat e ofruara nuk mund të identifikohet objekti se ku ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore, andaj në prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në struktura metalike dhe ndriçuese të dekorimeve publike festive të Vitit të Ri, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, përkatësisht provat e ofruara nuk përmbushin objektivat ligjore për të provuar shkeljen e pretenduar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Amr.51/2025 më datë 30.12.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.